

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**EMËRTIMI I PROJEKTIT:
FUNKSIONIMI I SPITALIT RAJONAL PUKE**

**VENDODHJA:
BASHKIA PUKE, QARKU SHKODER.**

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar,
pika 12.2 “Spitalet”, Te gjitha instalimet Leje Mjedisi tipi B.

**Kërkues:
“DREJTORIA E SHËRB. SPITALOR PUKE”**

Janar, 2017

TABELA:

STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM

Hyrje

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR	3
2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....	4
3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.....	6
4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.	16
5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.	20
6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....	23
7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS	23
8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.	23
9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....	23
10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).	26

HYRJE

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te subjektit “DREJTORIA E SHËRB. SPITALOR PUKE”, me administrator Z. Enver Sulejmani. Ky subjekt, ka paraqitur kerkesen per hartimin e procedures se konsultimit me publikun prane AKM dhe do te aplikojte prane QKB-AKM per pajisjen me Leje Mjedisore te tipit B per aktivitetin e Kompleksit Spitalor Puke.

Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte aktiviteti i Spitalit Rajonal Puke. Ky aktivitet ndodhet ne kompleksin Spitalor Puke, Bashkise Puke, Qarku Shkoder. Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, parashikon ndikimet ne mjedis qe mund te shkaktoje aktiviteti nga funksionimi i tij.

Ky aktivitet, zhvillohet ne nje kompleks me siperfaqe rreth 7470m², ne te cilen ndodhen 3 godina kryesore.

Sqarim:

Bazuar ne shtojcat I dhe II te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, ky aktivitet nuk perfshihet ne listen e aktiviteve qe i nenshtrohen procedures paraprake ose te thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet per te informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit mbi ndikimet ne mjedis te aktivitetit.

Ortofoto e vendodhjes se aktivitetit



Koordinatat e objektit ne sistemin Universal		
Nr.	Koordinatat Lindje	Koordinatat Veri
1	4409059.06	4657147.10
2	4408945.05	4657176.67
3	4408907.10	4657144.63
4	4409065.89	4657108.29

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjive të propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet përberëse të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.


Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe dëmtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerëzore dhe natyrore. Nder ligjet më kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- **Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Ligj Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Për menaxhimin e zhurmave”.**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.**
- **Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për zhvillimin e procedurave të VNM-se”.**
- **Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.**
- **Vendim Nr. 628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”.**
- **Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave”.**

2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Aktiviteti ne vleresim eshte Spitali Rajonal Puke i ndodhur brenda qytetit te Pukes, Bashkia Puke, Qarku Shkoder. Ky aktivitet eshte i perbere nga nje kompleks spitalor me 3 godina kryesore. Terreni eshte malor, terren shume i thyer. Bimesia qe karakterizon kete zone eshte kryesisht bimesi barishtore, ne pjeset e shpateve te kodrave eshte shkurre dhe peme te larta. Ky aktivitet nuk ndodhet ne toka bujqesore dhe nuk prek zona pyjore, apo zona te mbrojtura me ligj. Klima eshte malore.



Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit.

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar

“Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull.

Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Lagunat Bregdetare

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqve të natës dhe insekteve. Çdo vit takohen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180.000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. 2 nga 9 llojet e shpendëve endemikë Europianë janë gjithashtu prezent në vendin tonë (Trishtili me mustaqe dhe Thëllëza e Malit). Gjithashtu 5 lloje të rrezikuara shpendësh takohen në Shqipëri si Pelikani kaçurel, Pata ballëbardhë, etj. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë.

Së paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një Rëndësie Ndërkombëtare për shpendët, të njohura me emrin IBA (Important Bird Area), dhe plotësojnë kushtet për të qënë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpendë dimëronjës uji secila.


Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tynellet e ndërtuara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës.

Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël, dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll këto 20-25 vjetët e fundit. Meqënëse kjo shpellë është bërë më e vogël dhe e tharë, ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjëlsh për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii* dhe *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne sipërfaqen e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të identifikuar, prandaj aktiviteti ndodhet disa rezervuare të vegjël të cilët janë krijuar vetë nga banorët e zonës për qëllim ujëjitje. Në afërsi të aktivitetit ndodhen gjithashtu edhe Rezervuarët e Hidrocentralit të Komanit dhe Vau Dejes. Këto rezervuare ndodhen në një distancë të largët nga aktiviteti, rreth 9km në vijë ajrore në veriperëndim të aktivitetit. Zona është me reliev malor dhe nuk ndodhet në afërsi të burimeve ujore të rëndësishme si Lumenjtë kryesore, Liqenë, Rezervuare apo Zona Bregdetare.

Në rajonin e Shkodrës ndodhen mjaft lumenj. Nder ta mund të përmendim Liqenin e Shkodrës, Lumin Buna, Lumin Drin dhe Lumin Kir.




Përshkrimi i zonave të mbrojtura përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive.

Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asetet e rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës

pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Sic shihet edhe ne harten e meposhteme, zona ne vleresim permban zonat e mbrojtura si meposhte:

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
FUNKSIONIMI I SPITALIT RAJONAL PUKE, BASHKIA PUKE, QARKU SHKODER.

MINISTRIA E MJEDISIT						VITI 2014-MARS	
RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHqipëRI							
Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3,000.0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,800.0
	KATEGORIA I	Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)			SHUMA I	2	4,800.0
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2,630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8,000.0
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,000.0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9,424.4
13	II	Tiranë,Durres		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29,216.9
		Tirane	Tirane	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26,772.7
		Durres	Kruje	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22,230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2,074.5
		Tirane	Kavaje	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukes	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastrë, Korce		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33,165.3
		Korce	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlore	Vlore	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, datë 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1,278.9
	KATEGORIA II	Park Kombetar - Kategoria II (PK)			SHUMA II	15	210,501.4
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,740.0
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syri i Kaltër	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MontNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676, datë 20.12.2002	750	0.0
	KATEGORIA III	Monument Natyre - Kategoria III (MN)			SHUMA III		3,470.0
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20,000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturum	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3,600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1,500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2, datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	VKM nr. 684, datë 02.11.2005	1	26,535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4,393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5,000.7
46	IV	Diber, Kukes		Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55,550.2
		Diber	Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20,663.4
		Kukës	Kukes	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34,886.8
	IV/1	Park Natyror Rajonal					
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, datë 03.04.2013	1	4,206.0
	KATEGORIA IV	Rezervat Natyror i Menaxhuan/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)			SHUMA IV	23	127,180.1
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19,738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23,027.0

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
FUNKSIONIMI I SPITALIT RAJONAL PUKE, BASHKIA PUKE, QARKU SHKODER.

52	V	Tiranë,Diber,Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
	KATEGORIA V	Peizazh I Mbrojtur - Kategoria V (PM)			SHUMA V	5	95,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	2,200.0
	KATEGORIA VI	Zone e Mbrojtur e Burimeve te Natyrore te Menaxhuara - Kategoria VI (ZBNNM)			SHUMA VI	4	18,245.0
	TOTALI i ZM					16%	799

Sip. Republikës	2,874,800.00	ZM pa Sip.Detare	15.54%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.5%	13,261.2
		Karaburun-Sazan		12,428.0
		Butrint		833.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%
				119,401.5

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave			
b	VKQ	Vendim i Keshillit te Qarkut			
c	MB	Ministria e Bujqesise			
d	ZM	Zone e Mbrojtur			

LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413,datë 22.08.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liqeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce,Devoll	Liqeni i Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr.Site 2151, dt 03.07.2013	15,118.6
	TOTALI					%/Totali Republikës	3.42%
							98,180.6

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAT E MBROJTURA
SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.
www.mjedis.gov.al

Monumentet Natyrore te Rrethit Shkoder.(Sipas VKM 676)

NR	MONUMENTI	NR	MONUMENTI
1	Burimi i Vrakes	22	Liqeni i Pejes
2	Olistolitet e Kodres se Tepese	23	Geshtanjat e Mguilit (Pult)
3	Mbihipja tektonike e Shirokes	24	Bliret ne Lesniqe
4	Fragment i Thyres tektonike Shkoder – Peje (Karme)	25	Kanioni i ures se Shtrenjte
5	Blloku Gravitativ e Gurit te Zi	26	Shpella e Zhyles
6	Ujevara e Thethit	27	Shpella e Melagjise
7	Rasa e Palajve	28	Shpella e Muriqit
8	Guri i Lekes	29	Kanioni i Grunasit
9	Shpella e Gjeçovit	30	Kerleka e Kakise
10	Portat e Shales	31	Shpella e Liqethit Cukal
11	Shpella e Thethit	32	Burimet e Kirit
12	Shpella e Gajtanit	33	Habitati i Salamandres Alpine
13	Pragu i Kapreit	34	Shpella e Kataraktit
14	Shpella e Jubanit	35	Fusha e Liqethit
15	Cirku i Gropes se Bukur se Jezerces	36	Pylli i ishullit te Franc Jozefit
16	Burimet e Shtarzes	37	Lisat e Minaqit (Domne)
17	Liqeni i Jezerces	38	Rrepet e Vorrezave te Ramajt
18	Pisha Flamur e qafes se Pejes	39	Rrapi i Hoxhe Dheut
19	Ura shkembore e Markzagores	40	Çinari i Tophanes

20	Burimet e Okolit – Thethit	41	Rrapi i Toplanes
21	Shpella e Majes se Arapit	42	Ahet e Gurres se Krenave

Mjedisi social-ekonomik

Popullsia

Sipas CENCUS 2011, popullsia e Shqipërisë është 2.8 milion banorë me një rënie prej 8% në dy dekadat e fundit. Gjatë periudhës 2001-2013, në Shqipëri, popullsia banuese është reduktuar në 10 qarqe dhe ka shënuar rritje vetëm në dy qarqe. Rënia e popullsisë përgjatë kësaj periudhe në të gjithë vendin ka qenë 8.2 për qind, por në Gjirokastrë popullsia ka rënë me 35.7 për qind ndërsa në Tiranë është rritur me 26.1 për qind. Në vitin 2013, qarku me popullsinë më të vogël ishte Gjirokastra me afërsisht 68 mijë banorë ndërsa qarku me popullsinë më të madhe ishte Tirana me 766 mijë banorë.

Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Bazuar në VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe Procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit”, MM nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Institutit të Shendetit Publik ka realizuar projektin “Monitorimi i cilësisë së ajrit në qytetet kryesore të vendit tonë” si Tiranë, Durrës, Korçë dhe Vlorë për vitin 2013.

Veprimtaria studimore e monitoruese, është fokusuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Vlerësimi dhe studimi i treguesve mjedisorë të gjendjes dhe ndikimit në mjedis
- Realizimi i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, LNP, PM10, NO₂, SO₂, Pb, O₃, CO dhe BTEX në stacione të përzgjedhura qëllimisht në zonat urbane më të rënduara, përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të refl ektuara edhe në VKM nr 803, datë 4.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”. Monitorimi i ajrit është realizuar me pajisje automatike, për indikatorët e gaztë NO₂, O₃ të dhënat regjistrohen çdo 30 minuta kurse të dhënat e SO₂ regjistrohen çdo 5 minuta, d.m.th matjet realizohen 100% të kohës vjetore. Të dhënat e monitorimit për pluhurat (PM10 dhe PM2.5) realizohet orare .

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mesatare për treguesit e monitoruar

Tab. 1 Të dhënat mesatare vjetore

Nr	Stacionet	PM10	PM2.5	NO ₂	O ₃	SO ₂
		ug/m ³	ug/m ³	ug/m ³	ug/m ³	ug/m ³
1	Tirana qender	33.5	17.8	41.6	49.4	-
2	ISHP	31.8	15.3	13	52.66	-
3	Vlore	34.37	16.11	7.25	75.25	-
4	Korce	27.52	-	5.06	66.2	5.83
5	Norma shqiptare	60	15	60	65	60
6	Standarti I BE	40	25	40	-	-


Situata për ndotjen nga PM₁₀ dhe PM_{2.5} . Pluhrat janë një nga ndotësit e ajrit që realisht shkaktojnë probleme serioze në shëndetin e njeriut.

Ndotja nga PM₁₀ dhe PM_{2.5} sipas rekomandimeve të OBSH është rreziku më i madh shëndetësor sot për ajrin urban në shkallë botërore, pasi grimcat me përmasa nën 10 mikron dhe 2.5 mikron mund të depërtojnë në pjesën e poshtme të mushkrive.

Kjo ndotje vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe është karakteristike për makinat e vjetra me motor dizel. Gjithashtu ndërtimi dhe infrastruktura në ndërtim janë kontribues në rritjen e PM₁₀.

GRAFIKU 1

Vlera vjetore e PM₁₀




Nga rezultatet e monitorimit të PM₁₀ dhe PM_{2.5}, sic vihet re dhe nga figura 1, përmbajtja mesatare vjetore e PM₁₀ nuk e tejkalon normën Shqiptare dhe standartin e BE në asnjë nga stacionet e monitoruara por problematik ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ku kemi tejkalim të ditëve që janë më të larta se norma ditore (Norma është 35 ditë të tejkaluara në vit).

Ndërsa përsa i përket PM_{2.5} mud të themi në të tre stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës vjetore të PM_{2.5} krahasuar me standartin vjetor Shqiptar në vlera të ulëta. Në stacionin e Vlorës kemi një tejkalim prej afërsisht 10%, në stacionin e ISHP është afërsisht sa norma ndërsa në stacionin e poliklinikës qendrore kemi një tejkalim prej afërsisht 20%.

GRAFIKU 2

Vlerat vjetore të PM_{2.5}



Kjo ndotje për PM₁₀ dhe PM_{2.5} vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve që lëvizin në rrugët me trafi k të rënduar, cilësia e lëndës djegëse, menaxhim joefi kas i trafi kut që shpie në dyndje dhe në kohë qëndrimi të gjatë si dhe mirëmbajtja e automjeteve.


Përmbajtja e ndotësive të gaztë (NO₂, SO₂)

Në vlerësimin e cilësisë së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin.

Në bazë të të dhënave të monitorimit, si duket dhe nga grafi ku i mëposhtëm ajri urban në përgjithësi rezulton i pastër nga ndotësit e gaztë (SO₂ dhe NO₂), pasi në të gjithë stacionet e monitoruara vlerat mesatare vjetore janë brenda normave të lejuara të normës Shqiptare dhe standartit të BE përjashtim bën Tirana qendër ku kemi tejkalim të lehtë të standartit të BE. Kjo është e pritshme pasi burimi kryesor i ndotjes në zonën përreth stacionit është trafiku i automjeteve që të shumta janë në orët e mëngjesit dhe të mbasdites.

GRAFIKU 3

Vlera vjetore e NO₂



Ndotësit Fotokimik

Në shumë mjedise urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimi në rritje i automjeteve dhe shkarkimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësive primare dhe përbërësve të tjerë të atmosferës. Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të konsiderueshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkarkimet e automjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban.


Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e atmosferës. Kushtet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32°C, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.

Në grafi kët e mëposhtëm janë të dhënat vjetore në stacionin e Vlorës dhe Korçës krahasuar me normën vjetore Shqiptare ku shihet qartë se kemi një tejkalim të kësaj norme në të dy stacionet e monitoruara. Në stacionin e Vlorës kemi një tejkalim në masën 16 % ndërsa në stacionin e Korçës kemi një kapërcim të ulët të kësaj norme.

Në grafi kun nr 5 kemi vlerat 8 orarëshe për periudhën në dy stacione të Poliklinikës qendrore dhe ISHP-së për periudhën Janar-Dhjetor 2013. Nivelet e larta të ozonit hasen në muajt e verës për efekt të rrezatimit më të fortë diellor.

GRAFIKU 4

Vlerat vjetore te O₃



Zhurmat

Nuk ka as monitorim te nivelit te zhurmave ne zonen ne vlersim, monitorimet jane kryer per disa pika te qyteteve kryesore duke qene se keto qytete kane ne disa pika te tyre trafik te renduar dhe zhvillime dinamike ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit. Zhurmat jane nje problem i zakonshem urban dhe me problematike ne segmentet me me shume qarkullim dhe trafik te renduar. Kjo zone, sipas inspektimit ne vend dhe hartave orientuese duket qarte qe nuk ndodhet ne zone me nivel zhurme te larte e mbi normat e lejuara.

Studimi i Gjendjes së Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore të Shqipërisë

Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve Drin, Buna, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjose është kryer në bazë të rezultateve të parametrave fiziko-kimike (temperatura, transparencë, pH, alkalinitet, percjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal) bërë në 18 stacione. Vlerësimi i cilësisë së ujërave të liqenit të Ohrit, Prespës dhe Shkodrës realizohet për treguesit fiziko-kimike në 5 stacione. Monitorimi është kryer nga IEUM. Kohzgjatja e studimit Qershor-Dhjetor 2012. Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore. Në aneks do të gjeni stacionet lumore dhe liqenore, të dhënat gjeografi ke të tyre dhe kodin në rrjetin e monitorimit si dhe rezultatet mesatare të monitorimit për 2012 Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve dhe liqeneve dhe krahasimi i vlerave të parametrave kimike me normat përbën një nga kërkesat e në Direktivat e Bashkimit Evropian për monitorimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve dhe liqeneve janë përdorur vlerat limite të përcaktuara në Direktivën e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659, për cilësinë e ujërave të ëmbla për rritjen e peshqve dhe klasifikimi i cilësisë së ujërave të ëmbla natyrore sipas Institutit për Studimet e Ujërave të Norvegjisë – NIVA.

Sipas këtij klasifikimi, parametrat e cilësisë së ujërave të ëmbla mund të ndahen në dy grupe:

1- në grupin e parë bëjnë pjesë ushqyesit, lëndët organike, përbërësit acide, grimcat e ngurta dhe bakteriet e fekaleve në ujëra.

2- në grupin e dytë metalet e rënda në nivelet mikro në ujë, sedimente dhe peshq.

Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore. Për vendmatjet lumore: temperatura, pH, alkalinitet, percjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal.

Temperatura e ujit ka një shpërndarje të vlerave të tyre sipas stines dhe në përgjithësi me të njëjtën ecuri si edhe temperatura e ajrit. Prania e gazit karbonik në ujëra me alkalinitet të

ulët i bën ato lehtësisht agresive. Ujrat me alkalinitet të lartë mbi 5 mg.ekuiv./L turbullohen shpejt gjatë qëndrimit të tyre në mjedis.

Per pershkrimin e cilesise se ujerave te zones kemi paraqitur rezultatet e monitorimit te kryer per lumenjte e Rajonit te Shkodres.

Lumi Drin dhe Bunë - lumi Drin është monitoruar në dy stacione Topojan dhe Bahcallëk. Stacioni Topojan na jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujit të Drinit të bashkuar - Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, ndërsa monitorimi i stacionit Bahçallëk jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujit para derdhjes në detin Adriatik. Lumi Buna përfaqësohet nga stacionet Ura e vjetër e Bunës dhe Muriqan.

Janë marrë gjithësej 8 analiza kimike.

- **Temperatura e ujit** për lumin Drin varion 23.2 – 24.10C në fazën e parë deri në 16.4 në fazën e dytë të monitorimit në muajin tetor dhe për lumin Buna 23.6 – në fazën e parë në 16.4 0C në muajin tetor.



- **pH** i US për lumin Drin varion nga 7.74 – 8.56 respektivisht per stacionet ura e Topojanit dhe Bacallëk. Për lumin Buna vlerat e pH luhaten 7.71 – 8.48 per stacionet Muriqan dhe 7.72- 7.87 per stacionin Ura e vjetër e Bunes. Ndryshimet stimore nuk e kalojne vleren 1 (0.15, 0.37 dhe 0.82). Sipas vlerave limite te Direktives Kuadër të Ujit, normës për mjedis ujqor acid dhe alkalinqurat e lumenjve Drin dhe Bunë kanë gjendje të mirë. Ata janë neutrale (Ph = 6.5 - 9).

Alkaliniteti - Nga matjet e kryera gjatë këtij viti shohim se vlerat luhaten nga 123-140 mol/l në fazën e parë dhe 128 -143 në fazën e dytë sipas stacioneve respektivisht Ura e Bahcallëkut, Ura e Topojanit, Ura e vjetër e Bunës dhe Muriqan. Luhatjet stimore janë të ulta nga 0 – 5 mol/l. Rritja e alkalinitetit në fazën e dytë shoqërohet me rritjen e pHdhe të lëndëve të tretura në ujë.

- Percjellshmëria elektrike -

Luhatet ne vlerat 277-285 µS/cm respektivisht Ura e Bahcallëkut, Ura e Topojanit dhe 240 - 274 µS/ cm Muriqan, Ura e vjetër e Bunës. Luhatjet stimore janë të ulta 2 – 7 - 9 e deri 49 µS/cm në urën e Topojanit. Në normat europiane nuk jepen kufi nj të cilësisë së ujrave për përcjellshmërinë elektrike. Megjithatë shikojmë se vlerat e marra në këtë fazë nga të dy lumenjte janë të ulta.

- Përmajtja e oksigjenit të tretur në lumenjtë Drin dhe Bunë varion në vlerat 7.33 – 8.86 mg/l për lumin Drin dhe 7.42 – 8.9 mg/l për lumin Buna. Luhatjet sezonale të oksigjenit në të dy lumenjtë janë të ulëta: për lumin Drin janë 0.8 dhe për Bunën 0.45 – 0.8 mg/l. Uljet e përmajtjes së oksigjenit në fazën e dytë lidhen me shkarkimet e mbetjeve si dhe pikën kritike në prurjet e lumenjve. Të dy lumenjte i klasifi kojmë në gjendje shumë të mire për nivelet e oksigjenit. Shih grafi kun e mëposhtëm.



